**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER ALMA M. BURGAJ**
**ADRESA NR.8, RR. E DIBRES, NR.403**
**TEL: 0672003856**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME ME KUSHT)

**Nr. repertori: 12797** **Nr. koleksioni: 6188**

**Tirane më 19/09/2025**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2025050690661749704

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A2025050690661749704

# KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(*TË SHOQËRISË* "LOV TAXI" *SH.P.K*)

Sot, më datë 19.09.2025, para meje Notere ALMA M. BURGAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.8, RR. E DIBRES, NR.403, u paraqit personalisht:

**SHITES**:
**Perparim Billa,** atësia Halil, amësia Lihe, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë E Dibrës; Nd. 100; H. 8; Ap. 7; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 06/02/1977, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037499749 dhe nr. personal H70206062Q.

**BLERES**:
**Ledion Prifti,** atësia Edmond, amësia Luljeta, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në TIRANË, me adresë Hamdi Sulçebe; Nd. 44; H. 1; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1012; Tiranë, lindur më 12/01/2002, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034959357 dhe nr. personal K20112002W.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "LOV TAXI" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1

PERSHKRIMI OBJEKTIT

**A.** Shitësi **Perparim Billa** është ortak i Shoqërisë **"LOV TAXI" shpk**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar dhe që ekziston nën ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NIPT M31730027F,, me seli në Tiranë, me kapital në vlerën 100.000 Lekë (njëqind mijë lekë), e ndarë në 1 kuotë , me vlerë nominale 100.000 Lekë, **("Shoqëria");**

**B.** Shitësi **Perparim Billa** është pronar dhe mbajtës i 1 (një) kuote ose 100 % e kapitalit; dhe

**C.** Shitësi **Perparim Billa** do të shesë tek Bleresi **Ledion Prifti** dhe Blerësi **Ledion Prifti** do të blejë nga Shitësi **Perparim Billa** 100 % të pjesëmarrjes së kuotave në kapitalin e Shoqërisë, që konsiston në 1 kuotë dhe që përfaqëson 100% % të kapitalit **("Kuotat").**

Këtu e më poshtë, në konsideratë të kësaj kontrate shitje kuotash, Palët bien dakord si më poshtë:

**NENI 1 BLERJA DHE SHITJA E KUOTAVE**

1.1. Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi nga Shitësi **Perparim Billa** tek Blerësit i Kuotave, që përbëjnë 100% të pjesëmarrjes së Shitësit në kapitalin e Shoqërisë.

1.2. Pas transferimit të kuotave, me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi do të jetë pronar i 1 kuote që përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqërisë dhe Shitësi do të humbasë çdo të drejtë pronësie, çdo të drejtë mbi dividentin apo çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia mbi këto pjesë të Kuotave.

## NENI 2 ÇMIMI I BLERJES DHE RREGULLIMI I ÇMIMIT

2.1 Çmimi total i blerjes së 100 % të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë është 100.000 lekë (njëqind mijë lekë) ose ekuivalenti në ndonjë monedhë tjetër i pranuar nga Shitësi **Perparim Billa ("Çmimi i Blerjes"**).

2.2 Në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, nga ana e blerësit është paguar çmimi total i saj, dhe se shitësi nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim në lidhje më pagimin e çmimit.

## NENI 3 PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

3.1 Shitësi **Perparim Billa** pranon dhe garanton se ka fuqi dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar dhe lidhur këtë Kontratë dhe përsa kohë nuk parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, asnjë veprim tjetër nuk është i nevojshëm të kryhet nga Shitësi për ta bërë këtë Kontratë të vlefshme dhe detyruese për Shitësin dhe me efekt detyrues kundrejt tij, në përputhje me termat e kësaj kontrate, apo për të kryer veprimet e parashikuara në këtë mënyrë.

3.2 Shitësi **Perparim Billa** pranon dhe garanton se ai ka titull të plotë ligjor mbi 100% të Kuotavetë Shoqërisë **"LOV TAXI" shpk** dhe se nuk ka hyrë në ndonjë Kontratë tjetër, paraprake apo përfundimtare, për shitjen e Kuotave.

3.3 Shitësi **Perparim Billa** pranon dhe garanton se Kuotat nuk janë subjekt i ndonjë barre, pengu në favor të ndonjë pale të tretë apo sekuestrimi nga ndonjë organ ligjzbatues.

3.4 Shitësi **Perparim Billa** pranon dhe garanton se deri në momentin që do të transferohen Blerësit, shoqëria nuk ka pushuar së paguari detyrimet dhe nuk është e paaftë ose në pamundësi për të paguar detyrimet , nuk ka asnjë urdhër apo vendim për likuidim të shoqërisë.

3.5 Shitësi **Perparim Billa** ka në pronësi në aktivet e shoqërisë mjete transporti për kryerjen e aktivitetit.

3.6 Shoqëria **"LOV TAXI"** shpk **është krijuar më 30.05.2023 dhe përveç kapitalit 100.000 lek, për kryerjen e aktivitetit ka kontribuar Ortaku i Shoqërisë, në këtë rast shitësi, në shumën 280.000 (dyqind e tetedhjete mije) euro deri në momentin e shitjes së aksioneve (sipas pasqyrave financiare të kontabilitetit deri më 10.09.2025 bashkëngjitur kontratës) shumë e cila kompania duhet t'ia likujdojë shitësit në momentin që ai largohet nga kompania.**

3.7 Shitësi **Perparim Billa** i deklaron dhe i garanton blerësit se në datën e nënshkrimit si dhe në datën e transferimit pohimet e mësipërme janë të vërteta dhe të sakta

**Shuma prej 145.000 (njeqind e dyzet e pese mije) euro do te kaloje me transferte banakre nga pala blerese tek llogaria e pales shitese.**

A2025050690661749704

**Shuma e mbetur prej 135.000 (njeqind e tridhjete e pese mije) euro do te kaloje me aplikimin e kredise nga pala blerese prane Credins Bank brenda 3 muajve nga data e nenshkrimit te kontrates.**

**NENI 4 PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË E BLERËSVE**

4.1 Blerësi **Ledion Prifti** garanton se ekzekutimi dhe lidhja e kësaj kontrate është ligjërisht e autorizuar dhe se Blerësi nuk ka pengesa ligjore apo pengesa të tjera për të hyrë dhe për të lidhur këtë kontratë. Kjo Kontratë është lidhur dhe përfaqëson një detyrim ligjor, të vlefshëm, detyrues dhe të detyrueshëm për Blerësin.

4.2 Blerësi **Ledion Prifti** garanton kthimin e kontributeve në para në shumën 280.000 (dyqind e tetedhjete mije) euro derdhur nga Ortaku Përparim Billa (shitësi) për blerjen e Aseteve të shoqërisë të cilat sipas inventarit janë të pasqyruara në pasqyrat financiare të shoqërisë.

4.3 Blerësi **Ledion Prifti** garanton kthimin e kontributeve të ortakut në kushtet ku shitësit Përparim BILLA, i cili është njëkohësisht edhe ortak i shoqërisë, largohet nga ortakëria me vendimin nr.2, datë 19/09/2025, (i shet aksionet në pjesëmarrje të shoqërisë në masën 100% të kapitalit të përkthyer në lek prej 100.000 lek)

4.4 Blerësi **Ledion Prifti** është i detyruar të mbajë evidencën e kthimit të huasë deri në përfundimin e saj, Huaja të likujdohet nëpërmjet transfertave bankare në favor të shitësit dhe blerësi është përgjegjës për likujdimin e plotë.

4.5 Blerësi **Ledion Prifti** është i detyruar të likujdojë dhe kredinë e mbetur e cila ka shërbyer për blerjen e Aseteve të shoqërisë të cilat sipas inventarit janë të pasqyruara në pasqyrat financiare të shoqërisë.

4.6 Në rast se pala blerëse nuk arrin të likujdojë detyrimet totale të ortakut brenda afatit, pala shitëse ka të drejtën e zgjidhjes së kësaj kontrate në mënyrë të njëanshme dhe pala shitese do te ktheje mbrapsht shumen prej 45.000 (dyzet e pese mije) euro ndersa pjesa tjeter prej 100.000 (njeqind mije) euro do te mbahet nga shitesi per mosrespektim te afatit te pageses.

**SHITES:**
**Perparim Billa**

Perparim Billa

**BLERES:**
**Ledion Prifti**

Ledion Prifti

**NOTERE**

**ALMA BURGAJ**